



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 7, datë 20.02.2017

Për

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.21, DATË 23.05.2016
“KRIJIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË
TIJ””**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja “d”, nenit 25, pikat 2 dhe 4, nenit 54, shkronja “ç” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 për “Krijimin e Këshillave Artistiko – Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve nr.1, datë 24.05.2005 për “Mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.21, datë 23.05.2016 për “Krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e një anëtari në Këshillin Artistiko-Kulturor, të aprovuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 21, datë 23.05.2016 mbi “Krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”.
2. Anëtari z. Ilir Kerni, Drejtor i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, zëvendësohet me znj. Entela Pineri, kritike libri, për mbulimin e fushës së librit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Drejtoria e Sporteve Profesionale dhe Komunitare, Drejtoria e Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI